





Instaloni dhe regjistroni aplikacionin COVIDSafe.




1. Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin COVIDSafe nga **Apple App Store** ose **Google Play Store**.




2. Pasi të instaloni, hapeni aplikacionin, lexoni se si mund ta ndalim përhapjen, pastaj selektoni

'Dua të ndihmoj' 

Lexoni informacionet se si funksionon COVIDSafe, dhe pastaj selektoni 'NEXT' (në vijim) 

Për informacione të përkthyer se si funksionon aplikacioni COVIDSafe vizitoni www.health.gov.au/COVIDSafe-language.



3. Lexoni informacionet për regjistrim dhe privatësi dhe pastaj selektoni

'Continue' (vazhdo) 

Politikën e privatësisë të përkthyer mund ta lexoni në www.health.gov.au/COVIDSafe-privacy



4. Duhet të jepni pëlqimin tuaj për grumbullimin e informacioneve tuaja. Ju lutem më poshtë lexoni deklaratën për pëlqim të regjistrimit.


Pajtohem që Departamenti i Shëndetësisë së Australisë të grumbullohet:

- Informacionet e mia të regjistrimit për të mundësuar ndjekjen e kontakteve nga ana e zyrtarëve shëndetësor të shtetit apo territorit.
- Informacionet e mia të kontaktit nga përdorues tjerë të COVIDSafe pasi që ata të dalin pozitiv në testin për COVID-19.

Nëse jepni pëlqim të grumbullohen informacionet tuaja të regjistrimit

dhe kontaktit, selektoni 'I agree' (pajtohem)

I agree



5. Për t'u regjistruar shkruani:

- **emrin tuaj (mund të jetë një pseudonim)**
- **grupin e moshës tuaj**
- **kodin postar tuaj**

Me pëlqimin tuaj, informacionet tuaja të regjistrimit do të përdoren nga ana e zyrtarëve shëndetësor të shtetit dhe territorit për t'ju kontaktuar nëse keni qenë i ekspozuar në koronavirus.

Pasi të shkruani detajet tuaja të regjistrimit

selektoni 'Continue' (vazhdo)

Continue



6. Shkruani **numrin tuaj të mobilit** dhe pastaj selektoni 'Get PIN' (merr PIN-in) për të verifikuar numrin.

Get PIN

Një zyrtar shëndetësor do të përdor numrin tuaj të mobilit për t'ju kontaktuar ju nëse:

- dilni pozitiv në testim, për t'ju kërkuar që të ngarkoni informacionet tuaja
- jeni i identifikuar se keni pasur kontakt të afërt me një përdorues tjetër të COVIDSafe që ka dalur pozitiv në testim, për t'ju këshilluar se çfarë të bëni.

Nëse ndihmoni një mik apo familjar për të shkarkuar aplikacionin, do të duhet të shkarkoni aplikacionin në telefonin e tyre dhe të shkruani numrin e tyre në aplikacion.



7. Pastaj do të merrni një mesazh tekstual që përmban PIN-in me 6 numra.

Shkruani PIN-in me 6 numra, dhe pastaj selektoni 'Verify'

Verify

Nëse nuk merrni PIN-in, selektoni 'Resend PIN'

Resend PIN

Nëse numri i mobilit nuk është i saktë, selektoni 'Is this mobile number wrong?'


Is this mobile number wrong?




8. Selektoni 'Proceed' (vazhdo) **Proceed** për të **aktivizuar Bluetooth® dhe Njoftimet**. Nëse zgjedhni të aktivizoni Njoftimet, do të merrni një njoftim nëse COVIDSafe nuk është aktiv.

Pasi që në mënyrë të suksesshme të regjistrohuni

selektoni 'Continue' (vazhdo) **Continue**



Për Android, do t'ju kërkohet të ç'aktivizoni optimizimin e baterisë. Mund të zgjedhni që të ndryshoni emrin e aparatit tuaj.



9. Pasi të regjistrohuni dhe të merrni leje, mbani aktiv aplikacionin COVIDSafe. Këtë mund ta konfirmoni nëse e shihni 'COVIDSafe is active'

(COVIDSafe është aktiv) **COVIDSafe is active** në ekranin e aplikacionit tuaj.




10. Për derisa është aktiv, COVIDSafe mbanë një regjistrim të sigurt për përdoruesit tjerë të COVIDSafe që i keni pasur. Me lejen tuaj zyrtarët shëndetësor do të përdorin këto informacione për të kontaktuar njerëzit nëse ju dilni pozitiv në testim.

Këto informacione mbeten në telefonin tuaj për 21 ditë dhe nuk mund të qasen përveç nëse jepni pëlqimin tuaj.

Ngarkimi i informacioneve tuaja në bazë vullnetare nëse dilni pozitiv në testim

11. Nëse dilni pozitiv në testim një zyrtar shëndetësor nga shteti apo territori juaj do t'ju kontakton për të marrur leje që t'u qaset informacioneve të grumbulluara nga aplikacioni COVIDSafe.

Nga aplikacioni selektoni 'Has a health official contacted you?' (a ju ka kontaktuar ndonjë zyrtar shëndetësor)



Konfirmoni se një zyrtar shëndetësor është duke kërkuar të ngarkoni informacionet tuaja

duke selektuar 'Yes' (po)


Nëse nuk ju ka kontaktuar një zyrtar shëndetësor, selektoni 'No' (jo)

Duhet të jepni pëlqimin për informacionet tuaja që ngarkohen. Nëse nuk jepni pëlqim, informacionet tuaja për kontaktet e afërta nuk do të ngarkohen. Nëse jepni pëlqim, informacionet tuaja për kontaktet e afërta do të ngarkohen dhe do të shpërndahen me zyrtarët shëndetësor të shtetit apo territorit për të kontaktuar njerëzit që kanë mundur të ekspozohen në virus.

Mund ta lexoni politikën e privatisë së COVIDSafe për më shumë detaje në www.health.gov.au/covidsafe-privacy

Nëse jepni pëlqim që vullnetarisht të ngarkoni informacionet tuaja, zgjedhni kutinë që

thotë 'I agree' (pajtohem) . Pastaj selektoni 'Continue' (vazhdo)




12. Zyrtari shëndetësor do të dërgon një PIN për të ngarkuar informacionet tuaja. Shkruani PIN-in, dhe pastaj selektoni 'Upload my information'

(ngarko informacionet e mia)

Selektoni 'Continue' (vazhdo) për të mbaruar procesin. Pasi të mbaroni procesin, informacionet ruhen në një sistem ruajtje me siguri të lartë.

Një zyrtar shëndetësor nga shteti apo territori juaj do t'u qaset informacioneve në aplikacion për të identifikuar njerëzit me të cilët keni pasur kontakt të afërt - brenda 1.5 metra për 15 minuta apo më shumë.

Kjo do t'i ndihmon zyrtarëve shëndetësor që më shpejt të njoftojnë njerëzit që kanë pasur kontakt të afërt me ju dhe mund të ekspozohen në koronavirus.



13. Zyrtarët shëndetësor gjithashtu mund t'ju kontaktojnë nëse jeni i identifikuar si kontakt i afërt me një përdorues tjetër të aplikacionit COVIDSafe që ka koronavirus. Në këtë rast, zyrtari shëndetësor mund t'ju këshillojë që të testohuni për virusin.

14. Mund të fshini aplikacionin COVIDSafe nga telefoni juaj në çdo kohë. Kjo do të fshin të gjitha informacionet e aplikacionit COVIDSafe nga telefoni juaj. Informacionet në sistemin ruajtës së sigurt nuk do të fshihen menjëherë. Ato do të shkatërrohen kur Ministria e Shëndetësisë do të deklaron fundin e pandemisë. Nëse do të dëshironi që më shpejt të fshihen informacionet tuaja nga sistemi i ruajtjes, mund të plotësoni formularin për fshirjen e të dhënave në COVIDSafe në <https://covidsafe-form.service.gov.au/>

15. Informacionet dhe privatësia juaj janë të mbrojtura rreptësisht me ligj. Lexoni politikën e privatësisë në gjuhën tuaj në www.health.gov.au/covidsafe-privacy.

Për më shumë informacione dhe mbështetje, thirrni **1800 020 080**.